REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno:	04-06-2021	
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-30-30038		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019,nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 datë 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03.06.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.Paykos L.L.C sh.p.k, me nr. biznestit 810843955 adresa Veternik Zona Industriale - Prishtinë me pronar Armend Zeqiraj,është shfrytëzues i pronave të paluajtshme të Komunës.

2.Pronat e paluajtshme të Komunës, gjenden në ZK Babush i Muhaxherëve, të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse si në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m²
1	P.Sh.Kuvendi KomunalLipjan	P-71409059-00559-4	Babush i Muhaxherëve	16132
2	P.Sh Kuvendi Komunal Lipjan	P-71409059-00555-2	Babush i Muhaxherëve	3868

1.Shfrytëzimi i pronave komunale do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

2.Qëllimi i dhënies në shfytëzim të pronave komunale është ndërtimi i ndonjë fabrike prodhuese-përpunuese, objekte tregtare apo të ngjajshme, sipas standardeve të përcaktuara konform dispozitave ligjore.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,Drejtorati i Inspektoratit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 30-30038

Lipjan, më 03. 06. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVO KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO
LIPJAN